



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Rev.nr.88/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Milena Gjeriq dhe Beshir Islami, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit B. Kadri Q. nga F., të cilin e përfaqëson Av. Arlinda Haziri nga F., kundër të paditurit NTP “L.” me seli në P., me pronar H. I. nga P., të cilin e përfaqëson me autorizim Av. Rrahman Kastrati nga Prishtina, për shkak të pagesës së qirasë, duke vendosur sipas revizionit të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.6406/2019 dt.4.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me 28.02.2024, mori këtë,

### A K T V E N D I M

HEDHET si i pas afatshëm revizioni i të paditurit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.6406/2019 datë 4.05.2023.

### A r s y e t i m i

Me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.6406/2019 dt.4.5.2023, është refuzuar si e pathemeltë ankesa e të paditurit NTP “L.” me seli në P., dhe është vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.970/13 dt.28.06.2019, me të cilin, me pjesën e I të dispozitivit të tij aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe detyrohet i padituri që paditësit në emër të qirasë mujore prej 200-euro në muaj, t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 9.400-euro, duke filluar nga dt.1.01.2012 deri në dorëzimin e banesës më

dt.2.12.2015, në afat prej 15 ditësh, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm. Me pjesën e II të dispozitivit të tij, detyrohet i padituri që paditësit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 374-euro, në afat prej 15 ditësh, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, i padituri ka paraqitur revizion për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që, të aprovohet revizioni, dhe siç thuhet në të, ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, aprovohet ankesa si e bazuar e të paditurit, prishet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas vlerësimit të afatshmërisë së paraqitjes së revizionit sipas nenit 211.1, lidhur me nenin 230 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjeti se:

Revizioni i të paditurit është i pas afatshëm.

Nga shkresat e lëndës dhe atë nga fletë kthesa me shenjën e shkresës C.nr.970/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, rezulton se i padituri e ka pranuar aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.6406/2019 të dt.4.05.2023, më datë 28.09.2023, e cila fletë kthesë është e nënshkruar nga marrësi dhe dorëzuesi, ndërsa, në anën tjetër, i padituri, revizionin e ka dorëzuar në Postën nr..., Prishtinë, Rekomande nr..., më datë 12.12.2023.

Ndërkohë që, sipas dispozitës së nenit 211.1 të LPK, kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, palët mund të paraqesin revizion brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e dorëzimit të aktgjykimit.

Pasi që revizioni nga ana e të paditurit të dytë është dorëzuar në Postë, sikundër u theksua më lartë, më datë 12.12.2023, pas afatit ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar me dispozitën e sipër cekur, i njëjti është dashtë të hedhet si i pas afatshëm nga se dita e fundit për paraqitjen e revizionit ka qenë data 28.10.2023 (ditë e Shtunë), përkatësisht, dt.30.10.2023 (dita e Hënë), ndërsa, revizioni siç u theksua më lartë, është paraqitur pas skadimit të këtij afati, më dt.12.12.2023, d.m.th. pas afatit të paraparë ligjor.

Nga se gjykata e instancës më të ulët nuk ka vepruar në pajtim me nenin 218 të LPK, që të hedh revizionin si të pas afatshëm, Gjykata Supreme e Kosovës me zbatimin e nenit 221 lidhur me nenin 211.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.88/2024 datë 28.02.2024

Kryetar i kolegjit,  
Mr.sc. Muhamet Rexha